



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Në përgjigje të shkresës suaj e cila është administruar pranë bashkisë Shkodër me email , në zbatim të dispozitave ligjore të parashikuara në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” , i ndryshuar; ligjin nr.119/2014 “Për të Drëjtën e Informimit”, I ndryshuar; ju informojmë se:

1.Në lidhje me pikën 1 të kërkesës, përsa i përket projekteve për mirëmbajtjen e segmenteve rrugore të qytetit, shprehem si më poshtë:

Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike, prane Bashkise Shkodërka këtë aktivitet në Mirëmbajtjen e Infrastrukturës rrugore si:

-Riparim I difekteve dhe dëmtimeve infrastrukturore.

-Rehabilitimi dhe Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve sipas emergjencave që krijohen apo dhe prioriteteve që përcaktohen në bashkëpunim me administrator te Lagjeve dhe të Njësive

-Mbushje dhe profilim i rrugëve të pa asfaltuara në Nj.A .

-Mbushje dhe nivelim i bankinave të rrugëve në Nj.A.

-Riparime asfaltike të rrugëve të dëmtuara

Objektivi që synojmë të arrijmë është:

-Mirëmbajtja e rrjetit rrugor funksional dhe brenda kushteve teknike, duke arritur nivelin e kërkuar në shërbim të përdoruesve të rrugës.

-Realizimi I Mirëmbajtjes së Infrastrukturës nga Ndërmarrja me një kosto sa më të ulët dhe menjëherë kur shfaqet problematika.

2. Në lidhje me pikën 2 të kërkesës për përmirësimin e ndriçimit dhe elementeve të sigurisë rrugore, shprehem si më poshtë:

Përsa i përket ndriçimit rrugor, përgjatë vitit 2024, dhe planet për vitin 2025 janë si mëposhtë:

Investimet e realizuara përgjatë vitit 2024:

-Përfundimi i projektit SEMP “Investime ne kuader te projektit “Bashki me shfrytezim inteligjen energjie” (Bashki te zgjuara energjie)”, ku u investua ne reabilitimin dhe përmirësimin e ndriçimit rrugor në 11 rrugë të qytetit Shkodër.

-Fillimi dhe implemintimi (vazhdim dhe pergjatë vitit 2025) i projektit “Ndriçim i rrugëve plazh Velipojë”, ku përgjatë vitit 2024 u vendosen 209 ndriçues te teknologjisë së fundit LED, të shpërndara në 8 rrugë në Velipojë.

-Investim me fonde të veta dhe punëtori të Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe Punëve Publike, për instalimin e 150 ndricuesve të rinj të shpërndara në të gjitha njësité administrative. Këtu mund të përmendim rrugë të reja të ndriçuara si Shtoj i Vjeter, Berdice e Madhe, Berdice e Mesme, Fshati i Paqes Shirokë, Dragoc, Fshat i Ri, Boks, Drisht, Sheldi, Rrenc, Vukatane, Juban, Gur i Zi, Vejukej dhe Gorice

Investimet që priten përgjatë vitit 2025:

-Investim në reabilitimin e ndricimit në rrugën Jeronim De Rada, ku priten modernizimi i këtij aksi me ndriçues të teknologjisë së fundit LED.

-Investim me fonde të veta dhe punëtori të Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe Punëve Publike, ku pritet instalimin i 120 ndricuesve të rinj të shpërndara në të gjitha njësité administrative.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

KRYETAR

Benet BECI